



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 janar 2013
Nr. ref.: RK 346/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI99/12

Parashtrues

Emine Tahiri

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Ac. nr. 583/2012, të 14 shtatorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Kadri Kryeziu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Emine Tahiri nga fshati Batllavë, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Ac. nr. 583/2012, i 14 shtatorit 2012, me të cilin hidhet poshtë padia e parashtruar kundër Aktvendimit nr. 5079885, të 27 janarit 2012, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm MPMS) - Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejshëm DAP), me të cilin Aktvendim është refuzuar kërkesa e parashtruesit që t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuar.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. nr. 583/2012, i 14 shtatorit 2012, me të cilin hidhet poshtë kërkesa e parashtruesit të kërkesës që t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuar, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të "*... vlerësojë ligjshmërinë e aktgjykimit dhe vendimit të organit administrativ të cilët kanë udhëhequr procedurën...*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56, pika 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 99/12, të 31 tetorit 2012), Gjyqtarja Snezhana Botusharova është caktuar Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. 99/12) është caktuar Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof. dr. Ivan Čukalović.
7. Më 19 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së vendimit për rastin Nr. KI99/12.
8. Më 6 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarës Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe prof. dr. Ivan Čukalović, i ka paraqitur Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papanueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesit të kërkesës i është njohur e drejta për pension për persona me aftësi të kufizuar, në periudhën nga viti 2006 e deri më 21.12.2011, dy herë me vazhdimë prej një viti dhe herën e tretë me kohëzgjatje prej tri vjetësh.
10. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga MPMS-DAP që t'ia vazhdojë të drejtën për pension për persona me aftësi të kufizuar. MPMS-DAP, me Vendimin nr. 5079885, e 29 dhjetorit 2011, hodhi poshtë kërkesën për shqyrtimin e shfrytëzimit të së drejtës për pension për persona me aftësi të kufizuar.

11. Më 26 janar 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj Vendimit nr. 5079885, të 29 dhjetorit 2011, të MPPMS-DAP.
12. Duke vendosur për ankesën e parashtruesit të kërkesës, MPMS-DAP, Këshilli për ankesa dhe pensione të personave me aftësi të kufizuar në Prishtinë, me vendimin nr. 5079885, e 27 janarit 2012, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit që t'i njihet e drejta për pension për persona me aftësi të kufizuar dhe ka vërtetuar vendimin e MPMS-DAP nr. 5079885, e 29 dhjetorit 2011.
13. Në vendimin nr. 5079885, e 27 janarit 2012, të MPMS-DAP, Këshilli për ankesa dhe pensione për personat me aftësi të kufizuar në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi kundër Gjykatës Supreme të Kosovës.
14. Duke vendosur për padinë e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 583/2012, e 14 shtatorit 2012, hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës me këtë arsyetim:

“Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë me vendimin nr. 5079885 të datës 29.12.2011, ia refuzon paditësës kërkesën për njohjen e së drejtës në pension me aftësi të kufizuar nga arsyeja se nuk i plotëson kriteret sipas nenit 3 të Ligjit 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar, dhe të njëjtin e bazon në konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të organit të shkallës së parë të datës 20.12.2011, i cili vlerëson se te paditësja nuk është paraqitur kufizimi i përhershëm i aftësisë punuese siç parasheh dispozita e sipër cekur ligjore.

Në procedurën sipas ankesës organi i padituri ka siguruar konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të paditurës nr. 5079885 të datës 20.02.2012, për vlerësimin e komisionit mjekësor të personave me aftësi të kufizuar të organit të faktit, i cili dakordohet me konstatimin dhe mendimin e komisioneve mjekësore të dhëna më parë. Prandaj edhe me vendimin e kontestuar refuzon si të pabazuar ankesën e paditësës e cila vërteton vendimin e atakuar.

Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore me ligj të autorizuar kanë vërtetuar se te paditësja nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, gjykata konstaton se organet administrative drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lartë, në bazë të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditësës që t'i njihet e drejta në pension invalidor”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cili nen i Kushtetutës së Kosovës është shkelur me këtë vendim të Gjykatës Supreme, vetëm se pohon si në vijim:

“Në shkresa të lëndës gjinden provat – raportet mjekësore, fletë lëshimet e spitalit që vërtetojnë gjendjen e rëndë shëndetësore të palës si: fletë lëshimi nr. 7814 i datës 30.12.2003 fletë përcjellja për ekzaminime Histopatologjike dhe Citologjike të datës 22.12.2003, raporti ultrasonografik i abdomenit i datës 27.12.2005, raporti i Qendrës Diagnostike Endokrinologjike i datës 28.05.2005, raporti nr. 1793 i datës 09.09.2005 dhe kartela personale onkologjike Tiranë.

Organi i administratës nuk ka vepruar konform gjendjes shëndetësore të palës dhe provave dhe fakteve të paraqitura, por pa kurrfarë baze ligjore në procedurë të

rivlerësimi ka refuzuar kërkesën për vazhdimin e së drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuara pa dhënë kurrfarë arsytimi për arsyen e refuzimit të kërkesës vetëm me një konstatim se te pala nuk ekzistojnë shkaqet për njohje –vazhdim të së drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuara”.

16. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesat në vijim:

“Përmes parashtrimi të kërkesës në Gjykatë dëshirojmë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të vlerësojë ligjshmërinë e aktgjykimit dhe vendimeve të organeve administrative që kanë proceduar në këtë procedurë, t’i anulojë dhe të obligojë Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që t’i evitojnë shkeljet ligjore dhe t’ ma vazhdojnë shfrytëzimin e së drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuar. Kjo e drejtë më është ndërprerë pa të drejtë”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Neni 48 i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

20. Parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese (*Shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005*). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e saj, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 48 të Ligjit.

21. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e saj dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para komisioneve mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë të MPMS-DAP dhe para Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009*).

22. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, që parasheh: “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, më 6 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani